Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**13.10.2023**	**26.10.2023**	**2023/0772**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.10.2023, Operatori Ekonomik (OE) "FORTESA SH.P.K." - Prizren, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0772, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "EL-BAU SHPK"- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirembajtja e rrugeve te rendit te trete me Zhavor", me numër të prokurimit: "651-23-2383-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal Gjilan. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 480,000.00 €.

Në lidhje me këtë aktivit të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0379, datë:18.08.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Nga ana e AK-së, KUVENDI KOMUNAL GJILAN, me rastin e udhëheqjes së procedurës së ri-vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, respektivisht duke mos respektuar dhe zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 379/23 të dt. 18.08.2023 si dhe duke e hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim, është vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke i shkelur dhe zbatuar gabimisht dispozitat ligjore të LPP-së Nr.04/L-042 (versioni i konsoliduar) dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 si në vazhdim:

1. Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së
2. Neni 2 të LPP-së
3. Neni 6 të LPP-së
4. Neni 7 të LPP-së
5. Neni 10 dhe 11 të LPP-së
6. Neni 24 par. 2 dhe 3 të LPP-së
7. Neni 52 par. 5 dhe 7 të LPP-së
8. Neni 55 par. 3 te LPP-së
9. Neni 56 par. 1.1 dhe 1.2 të LPP-së
10. Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së
11. Neni 60 par. 1.1 të LPP-së
12. Neni 61 par. 2, 4 dhe 5 të LPP-së
13. Neni 108/A par. 3.2 të LPP-së
14. Neni 40.1 i Rregullores 001/2022 për PP
15. Neni 40.8 dhe 40.9 pika b) dhe 40.10 pika b) iRregullores 001/2022 për PP
16. Neni 41.8. 41.9 dhe 41.10 pika - b) i Rregullores 001/2022 për PP
17. Neni 42 i Rregullores 001/2022 për PP
18. Neni 45.23 i Rregullores 001/2022 për PP
19. Neni 60.1 i Rregullores 001/2022 për PP
20. Neni 97.1.h, 97.1.e, 97.1.p i Rregullores 001/2022 për PP

Pretendimet ankimore

Me datën 28 Mars 2023, AK – KUVENDI KOMUNAL GJILAN përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur inicimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor" me nr. prokurimi: 651-23-2383-2-1-1.

Operatori Ekonomik "FORTESA SHPK" ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me OE ALBAPROJECT SHPK duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues me datën 25.05.2023 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK të vlerësimit fillestar, tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë OE EL-BAU SHPK dhe ofertën tonë e vlerëson si tenderues të pasuksesshëm duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së.

Pas marrjes së Vendimit të Autoritetit Kontraktues për vlerësimin fillestar ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar nga ana e AK-së dhe pastaj kemi vazhduar me ankesë në OSHP e cila ankesë është aprovuar si e bazuar si dhe aktiviteti i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim (Vendimi nr. 379/23 i OSHP-së).

Tek ky vendim i OSHP-së, të gjitha pretendimet tona janë vlerësuar si të bazuara ndërsa Paneli shqyrtues ka mbështetur shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka konfirmuar se OE i

rekomanduar ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe të cilat nuk korrespondojnë me çmimet e tregut. Andaj me këtë konkludim si dhe me vendim të OSHP-së me automatizëm ky OE është i papërgjegjshëm si dhe e humb statusin e palës së interesuar që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së.

Pas kësaj AK me dt. 22.09.2023 15:11 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK për rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit tek i cili vendim AK rekomandon OE e njëjtë për shpërblim me kontratë duke mos respektuar dhe zbatuar vendimin e OSHP-së e cila konsiderohet si Shkelje e rëndë sipas paragrafit 1.h. të nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 e cila pastaj do të duhej të vazhdonte me zbatim të nenit 131 si dhe të nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së deri në anulimin e licencës së menaxherit të prokurimit të AK.

Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 23.09.2023 ku pastaj qasja është mundësuar me dt. 25.09.2023, pas kësaj ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim pranë AK e dorëzuar me datë 27.09.2023 08:27 derisa përgjigja na është kthyer me datë 02.10.2023 15:47 në bazë të vendimit me të cilin AK nuk i ka marrë parasysh argumentet tona për vlerësimin kundërligjor që është bërë në lidhje me këtë AP dhe në të njejtën kohë ka vazhduar me shkelje tjera të rënda duke e hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim edhe pse e njejta është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me LPP-në si dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022.

Duke u bazuar në nenin 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së, nenin 42 paragrafi 6 dhe nenin 60 paragrafi 1 të RRPP-së, vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt. 22.09.2023 15:11 që nënkupton se kjo ka qenë data e njoftimit dhe është "dita 0" e 5 ditëve të obligueshme të periudhës "në pritje". Nga kjo del se afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim ka qenë me dt. 27.09.2023 16:00. Ndërsa ne kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim me dt. 27.09.2023 08:27, pra brenda afateve kohore të përcaktuara me dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së, Në këtë rast AK më saktësisht ZPP ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së, nenit 42 si dhe nenit 60 paragrafi 1 të RRPP-së duke bërë interpretim qëllimisht të gabuar të këtyre dispozitave me të vetmin qëllim që të vazhdoj me procedurat për nënshkrim të kontratës dhe pastaj në rast të ankesës në OSHP, të shpresoj nga Paneli Shqyrtues se duke u thirrur në interesin publik sipas nenit 104 paragrafi 4 do ta lë në fuqi kontratën. Pra e gjitha kjo po bëhet qëllimisht nga ZPP që të favorizoj OE e rekomanduar për shpërblim me kontratë për arsyjet të cilat i jemi drejtuar organeve tjera kompetente.

Me këtë shkelje ZPP ka bërë njëkohësisht Shkelje tjetër të rëndë (Neni 97.e dhe Neni 97.p të RRPP-së) andaj kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të vë në zbatim nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së duke kërkuar nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së.

ZPP në dijeni të plotë se kërkesa për rishqyrtim është brenda afateve kohore në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim është përgjigjur edhe në pretendimet tona me arsyetimin "Pavarësisht faktit se për një ankesë e parashtruar pas afatit ligjor AK nuk ka obligim të lëshohet në

vlerësimin meritor të pretendimeve ankimore, AK duke u nisur nga parimi barazisë, mosdiskriminimit dhe zgjidhjes së drejtë e të ligjshme të lëndës, i ka shqyrtuar në mënyrë meritore të gjitha pretendimet e OE ankues".

Përgjigjet e AK-së në këto pretendime paraqesin arysetimet e njejta si tek raporti i vlerësimit të tenderëve dhe të cilat nuk i arsyetojnë Shkeljet e rënda që janë bërë me rastin e rivlerësimit.

Andaj për këtë arsye i drejtohemi OSHP-së që të parandalojmë këto Shkelje të rënda nga AK dhe në vazhdim do të paraqesim pretendimet e njejta të cilat janë paraqitur në kërkesën për rishqyrtim.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t'i parashtrojmë në këtë "Ankesë" kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet e vlerësimit të prokurimit.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi i parë

AK dhe ZPP nuk ka respektuar dhe zbatuar vendimin e OSHP-së nr. 379/23 në këtë mënyrë ka bërë Shkelje të rëndë sipas paragrafit 1.h. të nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022.

Tek ky vendim i OSHP-së, të gjitha pretendimet tona janë vlerësuar si të bazuara ndërsa Paneli shqyrtues ka mbështetur shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka konfirmuar se OE i rekomanduar ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe të cilat nuk korrespondojnë me çmimet e tregut. Andaj me këtë konkludim si dhe me vendim të OSHP-së me automatizëm ky OE është i papërgjegjshëm si dhe e humb statusin e palës së interesuar që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së.

Pas kësaj AK me dt. 22.09.2023 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK për rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit tek i cili vendim AK rekomandon OE e njëjtë për shpërblim me kontratë ndërsa pas qasjes në raportin e rivlerësimit vërehet se AK nuk ka bërë hulumtim të tregut për

çmimet jo-normalisht të ulëta ashtu siç është kërkuar nga Paneli Shqyrtues mirëpo ka kërkuar prapë një rikonfirmim nga ky OE se a qëndrojnë mbrapa ofertës financiare për përmbushjen e kontratës. Pra, AK duke qenë në dijeni se me hulumtim të tregut nuk mund të arsyetoj këto çmime ka përdorur prapë metodën e njejtë si gjatë vlerësimit fillestar për të vetmën arsyje që të favorizoj dhe rekomandoj për shpërblim me kontratë të njejtin OE.

Pra, në bazë të vendimit të OSHP-së, AK nuk ka qenë e nevojshme të kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë sepse të njejtën e ka bërë gjatë vlerësimit të parë e që këtë sqarim e ka hedhur poshtë vendimi i OSHP-së. AK në bazë të vendimit është dashur të bëjë vlerësim të tregut në çmimet e kontestuara apo të realizoj analizë të çmimit për pozicionet që konsiderohen çmime jo-normalisht të ulëta. Për këtë arsyje do të kërkojmë nga OSHP që të vazhdoj me zbatim të nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Pretendimi i dytë

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik pasi ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një OE i cili në 45% të tërësisë së tenderit (12 pozicione nga 27 në total) ka ofertuar me çmime manipulative në kundërshtim me çmimet/kushtet e tregut që si rrjedhojë rrezikojnë parametrat, cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës, konstatim ky i ekspertit shqyrtues dhe i cili është mbështetur edhe nga ana e panelit shqyrtues tek Vendimi nr. 379/23.

Pra, duke analizuar edhe çmimet dhe kushtet e tregut kemi vërejtur se oferta financiare (parallogaria) në shumicën e elementeve/pozicioneve të paramasës është me çmime të cilat në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut andaj në pikpamje faktike fillimisht përbën tender jo të besueshëm dhe me çmime manipulative i cili ka për qëllim të shtrembërojë konkurencën e drejtë të OE ankues dhe tenderuesve pjesëmarrës, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me çmimet dhe kushtet e tregut dhe konkurrencës. Kësisoji dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në perfomancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës.

Çmimet të cilat pretendojmë se nuk korrespodojnë me çmimet e tregut të cilat janë konfirmuar edhe nga paneli shqyrtues janë:

	Punet e leshesave	Njesia	Sasia	Çmimi me TVSH
1	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshësave, pjëseve kaluese dhe kanaleve te mbyllura ne disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (ne qmim te llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor)			
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1200 mm	m'	1	5,00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1000 mm	m'	1	3,00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 800 mm	m'	1	2,00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 600 mm	m'	1	2,00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 500 mm	m'	1	2,00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 400 mm	m'	1	2,00
2	Punimi i kokave hyrese dhe dalese nga betoni i armuar, mvaresisht prej diametrit te gypit.			
	Ø 1200 mm	copë	1	2,00
	Ø 1000 mm	copë	1	1,00
	Ø 800 mm	copë	1	1,00
	Ø 600 mm	copë	1	1,00
	Ø 500 mm	copë	1	1,00
	Ø 400 mm	copë	1	1,00

Në këtë rast për të dëshmuar edhe më mirë këtë ne kemi kontaktuar me të njëjtin prodhues të gypave të betonit me të cilët ky OE ka paraqitur se ka marrëveshje për furnizimet e këtyre gypave dhe kemi kërkuar ofertë për këto lloje të gypave. Ofertën e kemi kërkuar vetëm për furnizimin e tyre, jo dhe montimin. Përveç kësaj oferte ne kemi kërkuar ofertë edhe nga dy prodhues tjerë në mënyrë që të kemi tri oferta dhe të fitojmë një mesatare të kostos së furnizimit të këtyre gypave.

Prandaj paraqesim edhe një tabelë ku përshkruhen këto çmime ndërsa ofertat e tyre do t'i bashkangjesim në këtë ankesë.

		Njesia	Sasia	BESHI COM	BETONI MB	PROGRES LLC	Mesatarja
Furnizimi							
1	Gyp armuar Ø 1200 mm	m'	1	90,00		100,00	95,00
2	Gyp armuar Ø	m'	1	55,00	55,00	50,00	53,33
3	Gyp armuar Ø 800 mm	m'	1	39,00	40,00	27,00	35,33
4	Gyp armuar Ø 600 mm	m'	1	26,00	28,00	22,00	25,33
5	Gyp armuar Ø 500 mm	m'	1	14,00	14,00	15,00	14,33
6	Gyp armuar Ø 400 mm	m'	1	10,00	10,50	12,00	10,83

Provë: Të bashkangjitura janë ofertat e këtyre kompanive dhe e-mali i komunikimit.

Andaj kjo ofertë e cila ka dallim substancial me çmimet reale të tregut rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës dhe kufizon / shtrembëron konkurencën e lirë të OE ankues në raport me ofertimet të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat dhe çmimet reale të tregut. Prandaj AK do duhej ta trajtoj si tender jo normalisht të ulët dhe të njoftoj KRPP brenda dy dite sipas nenit 41.10 pika b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët" ashtu siç ka vepruar me rastin e njejtë tek aktiviteti i prokurimit "Pastrimi i Lumenjëve dhe prrockave" ku është eleminuar një OE për çmime jo- normalisht të ulëta për pozicionet e njejta dhe çmimet e njejta me këto të OE të rekomanduar tek ky aktivitet i prokurimit. Si dëshmi e kësaj qëndron ankesa në OSHP nr. 458/23 e këtij OE.

Edhe përkundër gjithë këtyre dëshmive AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë të njëjtin OE pa realizuar asnjë hulumtim të tregut për këto pozicione e për të cilën ka qenë e obliguar ta bëjë duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara. Andaj ky pretendim duhet të trajtohet si çështje e gjykuar "res judicata" sipas nenit 105 paragrafi 2.16 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP që të vlerësoj këtë ofertë si ofertë të papërgjegjshme pasi në vendimin e OSHP-së nr. 379/23, eksperti shqyrtues ka realizuar hulumtim të tregut dhe ka pohuar se këto çmime nuk korrespondojnë me çmimet e tregut, ndërsa AK nuk ka realizuar hulumtim të tregut pasi qëllimi i tyre është që të favorizoj këtë OE dhe kjo dyshojmë se do të bëhet prapë edhe pas këtij vendimi.

Pretendimi i tretë

AK ka vlerësuar ofertën tonë si të pasuksesshme dhe njëkohësisht ka bërë një analizë të ofertës të

paraqitur nga ana jonë si dhe ofertës së OE të rekomanduar duke konstatuar se kemi ofruar çmime mbivlerësuese dhe se oferta jonë është e dëmshme financiarisht për buxhetin e AK-së.

Fillimisht asnjëra nga këto nuk qëndron si dhe AK ka konstatuar diçka për të cilën nuk ka zhvilluar hulumtim të tregut si dhe analizë të çmimit për secilin pozicion mirëpo këtë konstatim e ka bërë vetëm duke i krahasuar ato me çmimet e OE të rekomanduar. AK në këtë analizë ka përgaditur një listë të pozicioneve të cilat janë kryesisht shërbime dhe i ka krahasuar ato me çmimet e OE të rekomanduar i cili ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta.

Pra pozicionet të cilat janë marrë për shqyrtim në këtë analizë nga AK janë shërbime, çmimi i të cilave varion sipas sasive të cilat duhet të ekzekutohen në terren. Marrim një shembull të thjeshtë: Nëse për një rrugë 1km janë të nevojshme makineritë si: eskavator, cilindër, kamion, grejder të njejtat janë të nevojshme edhe për një rrugë 20 metra. Pra në këtë kontratë nuk dihen sasitë indikative dhe kemi të bëjmë me një kontratë publike kornizë për të cilën kompania e kontraktuar duhet të jetë e gatshme të ekzekutoj punime edhe për sasi shumë të vogla. Për këtë arsyje AK ka vendosur që kjo kontratë të vlerësohet në bazë të peshimit dhe jo në bazë të sasive. Në këtë rast AK ka qenë e nevojshme të kërkoj sqarim nga OE i rekomanduar për këto çmime jo-normalisht të ulëta dhe jo të merren si avantazh i këtij OE. Prandaj, lind pyetja:

1. Nëse gjatë ekzekutimit do të kërkohet të punohet një rrugë me zhavor prej 20 metrave gjatësi në një lokacion në distancë prej disa km nga baza e makinerisë së këtij OE. A do të mund të arsyetohet çmimi njesi prej 1.50€/m në pozicionin 1 tek Punët përgaditore: "Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues në vendëpunishte"? Që nënkupton se transporti i të gjitha makinerive si dhe e stafit punues në vendëpunishte të bëhet në çmim prej 30€. Kjo është e qartë që nuk mund të bëhet.

Poashtu lind pyetja tjetër:

2. A është i informuar OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë se cilat rrugë do të punohen pasi me çmimet që ka ofertuar paraqitet ky dyshim. Poashtu edhe AK me krahasimin e bërë prej 1km presupozon se kemi të bëjmë me rrugë të gjatësive të mëdha, atëherë pse nuk janë parashikuar sasitë nëse ato dihen?

Pra krahasimi i bërë nga AK është absurd si dhe vërehet lehtë se AK nuk po trajton operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Poashtu AK në këtë krahasim ka marrë në shqyrtim vetëm pozicionet të cilat OE i rekomanduar i ka me çmim më të ulët ndërsa nuk i ka paraqitur çmimet e këtij OE të cilat janë mbi çmimet e tregut.

Për këtë arsyje paraqesim edhe një listë të pozicioneve për të cilat OE i rekomanduar ka paraqitur çmime manipuluese dhe të cilat pozicione janë të poentuara me përqindje më të madhe tek të

cilat interesi i AK-së ka qenë që të marr çmime më të favorshme për këto pozicione pasi duke marrë parasysh emërtimin "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor" si dhe natyrën e kontratës, këto pozicione do të punohen më së shumti gjatë ekzekutimit të kontratës.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Çmimi për njësi (me TVSh)-€ nga FORTESA SHPK & ALBAPROJECT SHPK	Çmimi për njësi (me TVSh)-€ nga EL-BAU SHPK
	Punët tokësore			
3	Gërmimi (rrënimi) i konstruksionit – bazës, (90+10%), gërmim i kombinuar kat. IV dhe V ; hapja e trases së re. Në çmim të llogaritet, gërmimi, ngarkimi dhe transporti I materialit të gërmuar deri 15km në deponi.	m³	3.05 €	7.00 €
	Punët e zhavorrit			
2	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=50 Mpa. , 0- 100 mm	m³	8.05 €	12.00 €
	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=60 Mpa. , 0- 63 mm	m³	11.95 €	16.00 €
	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=70 Mpa. , 0- 31 mm	m³	12.05 €	16.00 €

Pra tek kjo tabelë shihet qartë se tek pozicionet kryesore të këtij aktiviteti të prokurimit OE i rekomanduar ka ofruar çmime të cilat janë mbi çmimet e tregut.

Ndërsa sa i përket pozicioneve tek oferta financiare e kompanisë sonë për të cilat AK i ka vlerësuar si çmime mbivlerësuese paraqesim një tabelë të thjeshtë duke paraqitur çmimet e të gjithë ofertuesve të cilët janë vlerësuar nga AK si ofertues të përgjegjshëm tek e cila tabelë vërehet qartë se nuk kemi të bëjmë me çmime mbivlerësuese në ofertën tonë por kemi të bëjmë me çmime jo-normalisht të ulëta nga OE i rekomanduar.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	EL-BAU SHPK	FORTESA SHPK & ALBAPROJECT SHPK	K.N.T.SH."TEUTA-M" sh.p.k	"Company Zuka Commerce " SHPK	Mesatarja
			Punët përgatitore				
1	Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues në vendëpunishte.	m	1.50 €	49.00 €	10.00 €	50.00 €	27.63 €
2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet	m	0.50 €	39.00 €	0.05 €	100.00 €	34.89 €

Pra ky ishte vetëm një shembull se nuk mund të bëhen këto lloj krahasime pasi kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk janë të parashikuara sasitë indikative dhe OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet të jetë i gatshëm për ekzekutim të të gjitha punimeve pa marrë parasysh gjatësitë dhe sasitë e rrugëve që do të punohen. Në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së pasi: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sqarimet në këtë pretendim i kemi bazuar në vendimet e mëparshme të OSHP-së, si vendimi nr. 39/23, 224/22, etj.

Në lidhje me këtë pretendim AK në përgjigjen e dhënë ka potencuar nenin 27 të RRPP-së më saktësisht paragrafin 15: "Nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pikë, mandej të peshohen pikët pasi që në ketë mënyre pikët më të larta të poentuar jo domosdoshmërish do të rezultojnë në çmimin më të ulët." Andaj vet AK ka bërë shkelje të nenit 27 të RRPP-së duke bërë krahasime të çmimeve të ofertës së OE të rekomanduar dhe ofertës sonë edhe pse kriteri për dhënien e kontratës është

tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të ofertës së përgjegjshme sipas poentimit.

AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-se dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Ndërsa sa i përket mosrespektimit të vendimit nr. 379/23 kërkojmë nga OSHP që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njejtën kohë të vazhdoj me zbatim të nenit

25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së ndaj ZPP pasi i njejti njihet për mosrespektime të vendimeve dhe urdhërave nga Paneli Shqyrtues, siç është rasti edhe për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini", aktivitet i cili është në procedurë të ankesës në OSHP me nr. 631/23.

Përveç këtyre pretendimeve, kemi edhe pretendime tjera për disa dyshime për të cilat do të duhet t'i drejtohemi organeve tjera kompetente pasi dyshojmë se persona përgjegjës të OE të rekomanduar po paraqesin ndikim të paligjshëm (Neni 130 i LPP-së) tek personat përgjegjës të prokurimit të AK-së. Këto dyshime i kemi pasi ky OE që prej datës 30.05.2023 kur kemi dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim ndaj vlerësimit fillestar ka ushtruar presion dhe shantazh ndaj kompanisë sonë dhe personave të tretë për tërheqje

nga ankesa e dorëzuar në OSHP duke prezantuar dokumente të ofertës tonë të cilat nuk kanë qenë të qasshme nga ky OE pasi kanë qenë të cilësuara si sekret afarist. Poashtu dyshimet tona janë edhe tek vendimet të cilat po përpilohen nga AK tek të cilat dyshojmë se janë të përpiluara nga vet OE i rekomanduar. Andaj këto për momentin paraqesin vetëm dyshime derisa të vërtetohen nga organet kompetente.

PROPOZIM

Andaj duke konsideruar se AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartëshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore, ku si pasojë e shkeljeve të tilla ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga GOE FORTESA SHPK & ALBAPROJECT SHPK pasi plotësojmë kriteret për dhënien e kontratës, kërkojmë nga OSHP të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë dhe duke u udhëhequr nga parimi i

ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimarrje, i propozojmë të merr këtë:

VENDIM

APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e OE "FORTESA SH.P.K." ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i publikuar me dt. 22.09.2023 në ueb faqe të KRPP-së ANULOHET dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

URDHËROHET AK që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe OE "FORTESA SH.P.K." lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP- së: PSh. 379/23.

Iniciohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK (menaxherit të prokurimit), sipas dispozitës së nenit 25, paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjitha palët qe kanë marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Vërejtje përmbyllëse ne lidhje me vlerësimin e tenderëve te përgjegjshëm:

Gjate hapjes se ofertave kane aplikuar gjithsej 8 (tete) OE ne formë elektronike, komisioni i vlerësimit gjate ekzaminimit dhe vlerësimit te ofertave ka konstatuar se 3 OE janë te pasuksesshëm : ndërsa katër OE ofertues janë te papërgjegjshëm si dhe një OE i suksesshëm për këtë aktivitet te Prokurimit është OE EL-BAU SH.P.K. vlerë prej 34.55 euro me çmimin për njësi. Duke vepruar mbi bazën rekomandimeve te vendimit te OSHP-se PSH.nr.379/23, Komisioni i Rivlerësimit e ka bërë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave të përgjegjshme për këtë aktivitet ne përputhje me te gjitha aspektet përmbajtjesore te kritereve të kualifikimit dhe kriterin e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftimin për kontrate ne dosjen e tenderit ne përputhshmëri me kriteret ligjore le përcaktuara ne nenin 59, nenin 61 dhe nenin 60 te LPP-se.

Andaj, duke vepruar ne pajtim me këtë ligj dhe ne përputhje te plote me parimet e trajtimit te barabartë, transparencës dhe ekonomicitetit, Komisioni i Rivlerësimit me datën 08.09.2023

nga OE i shpërblyer me kontrate "El-Bau" Sh.p.k. ka kërkuar rikonfirmimin se a qëndrojnë mbrapa ofertës financiare për përmbushjen e kontratës duke përfshirë edhe rikonfirmimin e çmimeve sipas marrëveshjes me OE "Eken Beton" Sh.p.k. dhe N.P.T. "Beshi Com" qe ishin ofruar me përgjigjën sqaruese te datës 15.05.2023 lidhur me kërkesat për sqarimet e tenderit abnonnalisht te ulet sipas nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41.4 le RRPP. Dhe po ashtu se a qëndrojnë mbrapa kërkesës se AK-se për rritje të sigurimit le ekzekutimit le kontratës nga masa l 0% ne masën 20% te çmimi le përgjithshëm te vlerës se parashikuar te kontratës. Operatori Ekonomik "El Bau" Sh.p.k. brenda afatit i ka kthyer përgjigje AK-se mete cilën e ka njoftuar AK- Komunën e Gjilanit se qëndrojmë ne tërësi mbrapa ofertës se tyre financiare përfshirë edhe rikonfinnimin e çmimeve sipas marrëveshjeve paraprake për secilin pozicion me furnitorët Eken Belon Sh.p.k. dhe N.P.T. Beshi Com duke u zotuar se kontratën do ta përmbushim sipas termave te paramases dhe kushteve kontratës me cilësinë e punës, cilësinë e materialeve dhe cilësitë profesionale ne pajtueshmëri te plote me standardet e ndërtimtarisë. Përgjigja e OE "El-Bau" Sh.p.k. është shoqëruar edhe me dëshmitë dokumentare të përgjigjes së furnitorit Eken Beton e cila përveç se ka rikonfirmuar marrëveshjen me te gjitha kushtet lidhur me sasinë, cilësinë dhe çmimin e ofruar ne lidhje me secilin pozicion te përshkruar ne marrëveshje për punimin, furnizimin dhe montimin e kokave hyrëse dhe dalëse nga betoni lidhur aktivitetin ne fjale ka ofruar edhe mundësinë e furnizimit le parakohshëm ne depon e kompanisë "El Bau" Sh.p.k, te specifikuar sipas marrëveshjes. Dhe po ashtu me dëshminë e përgjigjes se furnitorit N.P.T. BESHI COM, e Belone cila përveç se ka rikonfinnuar marrëveshjen me le gjitha kushtet lidhur me sasinë, cilësinë dhe çmimin e ofruar ne lidhje me secilin pozicion te përshkruar ne marrëveshje për punimin, furnizimin dhe montimin e gypave te betonit lidhur me aktivitetin e ne fjale për me tepër ka ofruar për AK-ne mundësinë për vizite ne depon e saj për verifikimin dhe vërtetimin e ekzistimit te sasisë se mjaftueshme për furnizimet e gypave te betonit, sipas marrëveshjes. Krejt ne fund e ka njoftuar AK-ne me ri konfirmimin se qëndron mbrapa pajtueshmërisë për rritjen e sigurisë se ekzekutimit te kontratës nga masa 10% ne masën 20% te çmimit te përgjithshëm te vlerës se parashikuar te kontratës sipas kërkesës se AK-se te datës 19.05.2023 apo edhe si opsion tjetër ka propozuar instrumentit ligjor te mbajtjen e parasë për ndalesën nga çdo pagese e kontraktuesit deri ne përfundimin e tere punëve ne shumen deri 20% le vlerës totale te kontratës. Komisioni i Rivlerësimit duke u bazuar nga te gjitha faktet, arsye dhe gjendjen faktike qe u përshkrua si me sipër, vlerëson se sqarimet dhe dëshmitë e ofruara nga OE "El-Bau" Sh.p.k. e arsyetojnë ofertën e saj mjaftueshëm ne aspektin përmbajtjesor financiar dhe teknik, andaj si te tilla janë te mjaftueshme, besueshme dhe bindëse e le pranueshme për AK-ne sepse përbejnë baze te mjaftueshme argumentuese se OE "El-Bau" Sh.p.k. do të përmbushë kontratën me cilësi dhe standarde sipas kushteve dhe kritereve te përcaktuara ne kontrate. Kjo është dëshmuar edhe ne kontratat paraprake ku OE ne fjale ka implementuar me sukses dhe cilësi kontrata me AK-ne duke përfshi edhe kontrata te kësaj natyre. Përveç; kësaj, duke qene se vlerësimi i çmimeve sipas paragrafit 4 te nenit 61 te LPP-se është e drejtë dhe diskrecion i AK-se, për te hequr çdo dileme rreth çmimeve qe do kenë te jene jo-normalisht le ulëta, AK duke vepruar sipas nenit 29.4 te Rregullores për Prokurim Publik Nr.001 /2022 si mase te sigurisë ka kërkuar nga OE "El-Bau" ShPK. rritjen e sigurimit le ekzekutimit te kontratës nga 10% ne 20% te çmimit te përgjithshëm le vlerës se parashikuar gjë qe OE ne fjale e ka pranuar dhe kjo konsiderohet mase shtese e sigurisë për implementimin e kontratës.

Si përfundim, duke u bazuar ne faktet dhe rrethanat e përshkruara si me sipër dhe duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit sipas nenit I dhe nenit 6 lidhur me nenin 60 te LPP-se qe përcaktohet se autoritetet kontraktuese janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet

publike te përdoren ne mënyrë efikase, te drejte, transparente dhe mënyrën me ekonomike, Komisioni i Rivlerësimit rekomandon Zyrtarin Përgjegjës te Prokurimit qe me kontratë të shpërblehet OE "El-Bau Sh.p.k. i cili ne mesin e tenderuesve ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulët te peshuar prej 34.55 euro për njësi. Krahas kësaj, Komisioni i Rivlerësimit i ka here analize edhe ofertës te paraqitur grupi i operatorëve ekonomik FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K., dhe si rezultat i rivlerësimit vlerëson se ne ofertën e tij ka pozicione me çmime mbivlerësuese dhe ekstremist te shtrenjta sikurse është tabela me pozicionet për punët përgatitore për fillimin e punimeve qe për 1 km vetëm për punët përgatitore dhe tokësore sipas kësaj oferte i kushtojnë buxhetit te AK-se 104,850.00€ €me diference prej 93,350.00€ apo 912% me shtrenjtë ne krahasim me çmimin prej 11,500.00 për këto pozicione nga oferta e OE i shpërblyer me kontrate. Prandaj, Komisioni i Rivlerësimit vlerëson se kjo oferte është edhe e dëmshme financiarisht për buxhetin e AK-se.

Për me tepër lidhur me qëllimin dhe lenden e prokurimit siç parashihet ne nenin 1 dhe 6 te LPP-se dhe sipas parimeve themelore te prokurimit, konkretisht parimit te efektivitetit/efikasitetit përcaktohet se për punën apo shërbimin e njëjte ne rastet kur kompaninë i plotësojnë kushtet dhe kriteret kualifikuese le dosjes se tenderit nënkupton qe për oferte te rekomandohet OE qe ka çmimin mete arsyeshëm, respektivisht mete ulet le ofertës se përgjegjshme ne mesin e tenderuesve te theksuar si me sipër.

Prandaj, duke qene se oferta e paraqitur nga ana e juaj nuk është ne mesin e tenderuesve te përgjegjshëm me çmimin me le ulet dhe për me tepër duke qene se oferta e juaj ne pozicionet e konstatuara si me sipër ka çmime mbivlerësuese ekstremisht të shtrenjta dhe është i dëmshëm financiarisht për buxhetin e AK-se, Komisioni i Rivlerësimit vlerëson qe tenderi i juaj është i pasuksesshëm andaj i rekomandojmë Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit qe si e tille le refuzohet.

Sa i përket Grupit te Operatoreve Ekonomik "AGRO INVEST 1 SH.P.K.; LORD GROUP SH.P.K.; Ennal Sylaj B.I.; OE K.N.T.SH. "TEUTA M" SH.P.K.; OE COMPANY "BEJTA COMERCE" SH.A.; "Company Zuka Commerce" Sh.p.k. dhe OE Pro & Co Group, Komisioni i Rivlerësimit vlerëson se nuk mund ta kenë statusin e palës se interesuar qe mund te dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit ne kuptim te paragrafit 1.26 te nenit 4 te LPP-se sepse nga ana e tyre nuk janë vene ne lëvizje mjetet juridike sipas LPP-se për kontestimin e rezultatit sipas Njoftim mbi Vendimin e AK-se me Letrën Standarde qe ju është drejtuar me date 25.05.023 dhe Vendimit te datës 01.06.2023 për hedhjen e palejuar te Kërkesës për Rishqyrtim te OE K.N.T.SH. "TEUTA - M" SH.P.K. Ne këtë mënyrë rezulton se me pohimin e tyre ne heshtje janë pajtuar me këtë rezultat, andaj rikonfirmohen arsyet e njëjta për eliminimin e tenderit te paraqitur nga ana e tyre sikurse ne Letrën Standarde te bashkangjitur me Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës 25.05.2023 i publikuar ne platformën e-prokurimi.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me datë 24.10.2023 Eksperti përmes emailit ka pyetur AK-në se cilat veprime i ka marrë pas vendimit

të OSHP-së 379/23 të datës 18.08.2023.

Me datë 25.10.2023 AK përmes emailit ka kthyer përgjigje duke bashkangjitur sqarimin me veprimet e AK-së dhe dokumente tjera të cilat prezantohen në përgjigjet në pretendimet ankimore.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Në lidhje me këtë aktivit të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0379, datë:18.08.2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FORTESA SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues me datë 27.09.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 02.10.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 (lidhur me ofertën e OE të rekomanduar)

- OE ankues pretendon se AK me vendimin e datës 22.09.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe vendimin e OSHP-së 379/23, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë me çmime jonormalisht të ulëta dhe AK nuk ka zbatuar kërkesat e vendimit të OSHP-së.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- Sipas procesverbalit të hapjes, në këtë aktivitet të prokurimit, ofertë kanë dorëzuar tetë OE:

1. OE - COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A.:me çmim 183.76 euro;
2. OE - "Company Zuka Commerce" Sh.p.k.: me çmim 202.14 euro;
3. GOE - FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K.: me çmim 69.88 euro (OE ankues);
4. OE - EL-BAU SH.P.K.: me çmim 34.55 euro (OE i rekomanduar);
5. OE - Pro & Co Group SH.P.K.: me çmim 29.23 euro;
6. GOE - AGRO INVEST 1 SH.P.K.; LORD GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I.: me çmim 55175.00 euro;

7. GOE - ARLINDI SHPK; Infra-Plus SH.P.K.: me çmim 98.55 euro;
8. OE - K.N.T.SH. Teuta - M SH.P.K.: me çmim 162.46 euro;

- Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, AK me datë 12.05.2023 konform dispozitave për tenderët jonormalisht të ulët, ka kërkuar sqarime nga OE "EL-BAU" lidhur me 12 pozicione.
- OE i rekomanduar për kontratë me datë 15.05.2023, ka kthyer përgjigje duke konfirmuar se oferta financiare është e besueshme dhe e zbatueshme sipas parametrave të cilësisë për ekzekutimin e kontratës, duke arsyetuar çmimet e vendosura bazuar në marrëveshjet që ka me dy kompani (N.T.P. BESHI COM dhe "EKEN BETON") me të cilat sipas arsyetimit OE i rekomanduar ka bashkëpunim afatgjatë. Shkresës i janë bashkangjitur edhe provat si vijon: 1.Marrëveshje për Punimin, Furnizimin dhe Montimin e Kokave Hyrëse dhe Dalëse nga Betoni, e lidhur në mes: "EL BAU" SH.P.K, Gjilan me numër të biznesit:811182576, dhe "EKEN BETON" SH.P.K me seli në Prishtinë, me numër të biznesit: 810104539. Marrëveshja mban datën 18.04.2023, dhe është nënshkruar dhe vulosur nga palët. Poashtu marrëveshja është e noterizuar me date 18.04.2023.; 2. Korrespodencën e emailave të këmbyer nga palët e sipërpërmendura, ku me datë 17.04.2023, OE "EL BAU" përmes email adresës "shpkelbau@gmail.com" kërkon ofertë për 6 pozicionet e gypave nga kompania "EKEN BETON" Sh.p.k në emal adresën ekenbeton@gmail.com. Me datë 18.04.2023, përmes emalit "EKEN BETON" SH.P.K i dërgon ofertën duke ju referuar një marrëveshje të brendshme në mes të palëve të vitit 2022.; 3. Marrëveshje për Punimin, Furnizimin dhe Montimin e Gypave të Betonit, e lidhur në mes: "EL BAU" SH.P.K, Gjilan me numër të biznesit:811182576, dhe N.T.P. BESHI COM me seli në Ferizaj, me numër të biznesit: 810670225. Marrëveshja mban datën 18.04.2023, dhe është nënshkruar dhe vulosur nga palët. Poashtu marrëveshja është e noterizuar me date 18.04.2023.; 4. Korrespodencën e emailave të këmbyer nga palët e sipërpërmendura, ku me datë 17.04.2023, OE "EL BAU" përmes email adresës "shpkelbau@gmail.com" kërkon ofertë për 6 pozicionet e gypave të betonit nga kompania "N.T.P. BESHI COM" në emal adresën "beshinpt@gmail.com". Në të njëjtën ditë, "N.T.P. BESHI COM" përmes emal adresës "beshinpt@gmail.com" dërgon ofertën finaciare për OE "EL BAU".
- Më tej, AK me datë 19.05.2023 ka dërguar kërkesë për OE "EL-BAU" me pyetjen se në rast rekomandimi për dhënie te kontratës a pajtohet me rritjen e vlerës së garancisë së sigurimit të ekzekutimit të kontratës në masën 20%.
- Në të njëjtën ditë, OE EL-BAU ka kthyer përgjigje duke u pajtuar me masën për rritjen e sigurisë së ekzekutimit të kontratës nga 10% në 20%.
- Me datë 25.05.2023, AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde, me te cilin njoftim e ka rekomanduar për shpërblim me kontratë OE "EL-BAU" Sh.p.k. me çmimin me të ultë në mesin e tenderëve qe i plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.
- Me datë 30.05.2023, OE "Fortesa" Sh.p.k., si palë e pakënaqur me vendimin e AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 01.06.2023. Kurse, me datë 09.06.2023, OE ankues ka ushtruar ankesë ne OSHP, kundër vendimit të cituar si me sipër të AK, e cila është evidentuar me numër te protokollit 379/23.
- Paneli Shqyrtues i OSHP përmes vendimit numër: 379/23 të datës 18.08.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka obliguar AK të bëjë rivlerësimin e ofertave.
- AK me datë 08.09.2023, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, duke kërkuar shpjegime të tenderit sipas pyetjeve si në vijim: "1.A qëndroni mbrapa

ofertës financiare duke përfshirë edhe çmimet sipas dëshmive (marrëveshjes me N.P.T. "BESHI COM", marrëveshjes me "EKEN BETON"Sh.p.k.) që i keni ofruar me përgjigjen sqaruese e datës 15.05.2023 lidhur me kërkesat për sqarimet për tenderin abnormalisht të ulët në kuptim të nenit 61 të LPP-së lidhur me nenin 41.4 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022.; 2. A mund të i rikonfirmoni marrëveshjet paraprake që i keni pasur me furnitorët N.P.T. "BESHI COM" dhe "EKEN BETON"Sh.p.k lidhur me çmimet për pozicionet e cekura në konfirmimet paraprake?; 3. Njëkohësisht a qëndroni mbrapa kërkesës tonë të datës 19.05.2023 për rritje të sigurimit të ekzekutimit të kontratës nga masa 10% në masën 20 % të çmimit të përgjithshëm të vlerës së parashikuar të kontratës? "

- OE i rekomanduar për kontratë me datë 13.09.2023 përmes përgjigjes ka rikonfirmuar se qëndron pranë ofertës financiare dhe zotimit për përmbushjen e kontratës sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në dosje të tenderit. Më tej OE ka konfirmuar se përmes përgjigjeve me shkrim dy kompanitë furnizuese ("Eken Beton" Sh.p.k dhe N.P.T. "Beshi Com") kanë rikonfirmuar çmimet e ofruara dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve. Në fund, OE deklaron se pajtohet me kërkesën e AK për rritjen e sigurisë se ekzekutimit te kontratës nga 10% ne 20% te çmimit total te kontratës sipas kërkesës se AK-se të datës 19.05.2023.
- AK pas sqarimeve të pranuara, sipas raporti të komisionit të rivlerësimit dhe përmes vendimit të datës 22.09.2023 e rekomandon për shpërblim me kontratë OE EL Bau Sh.p.k.
- Me datë 24.10.2023 Eksperti përmes emailit ka pyetur AK-në se cilat veprime i ka marrë pas vendimit të OSHP-së 379/23 të datës 18.08.2023.
- Me datë 25.10.2023 AK përmes emailit ka kthyer përgjigje me tekstin si vijon: "*Andaj, lidhur me objektin e zbatimit te vendimit te OSHP-se 379/23 te dates 18.08.2023, AK - Komuna e Gjilanit gjate rivleresimit te aktivitetit pas shqyrtimit dhe analizimit konkret te shkresave te lendes, rekomandimeve te panel it shqyrtues dhe administrimit te provave ne teresi te gjithe aktivitetit te prokurimit te lartshenuar, ne kuader te veprimeve kyrre dhe percaktuese qe kane sjellur vendimarrjen sikurse ne Njoftim mbi Vendimin e AK-se te dates 22.09.2023, nder tjera ka ndennarre veprimet e shpjeguara sine vijim: 1. Procesi i rivleresimit eshte here duke ndennarre te gjitha veprimet ne perputhje te plote me kerkesat procedurale dhe qenesore te dispozitave te nenit 59, nenit 60, nenit 61 te LPP-se duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet me nenin 1 dhe 6 te ketij ligji. 2. Gjate procesit te rivleresimit lidhur me rrmimet e OE te shperblyer me kontrate qe jane konsideruar si te uleta per pozicionet "punet e leshesave" qe perbejne 20% te puneve nga totali i kontrates kemi marre rikonfinnimet e ~mimeve te ofertes se OE "El-Bau" e cila ka rikonfinnuar se i qendron mbrapa ofertes se tij, pastaj rikonfirmimet e rrmimeve nga furnitoret OE "Eken Beton" Sh.p.k. dhe N.P.T. "Beshi Com" te cilet e kane rikonfirmuar se qendrojme ne teresi mbrapa ofertes se tyre financiare duke e ofruar edhe mundesine e furnizimit te parakohshem ne depon e OE te shperblyer me kontrate per aktivitetin ne fjale. Kesisoji duke vepruar konform nenit 61 par.3 te LPP-se dhe dispozitave tjera relevante te prokurimit AK eshte pajtuar me sqarimet dhe arsyetimet e dhena nga OE i shperblyer me kontrate dhe furnitoret e lartshenuar duke marre parasysh se OE i rekomanduar qendron mbrapa ofertes se tij duke u zotuar permbushjen e saj bazuar ne dokumentacionin e paraqitur. AK-ja ka vleresuar se OE ka dhene sqarime duke arsyetuar oferten e tij ne menyre te mjaftueshme dhe bindese per AK-ne, andaj duke qene se oferta e tij eshte me i;mimin mete lire se oferta e OE ankues e ka rekomanduar me shperblim te kontrates. 3. Njekohesisht si mase sigurie AK-ja i ka zbatuar instrumentet ligjore qe ka ne dispozicion para dhe pergjate implementimit te kontrates, sir; eshte rritja e sigurimit te ekzekutimit sipas nenit 63 te LPP-se dhe nenit 29.4 te RRPP Nr.001/2022*

sipas kritereve dhe standardeve te percaktuara ne relacion me % e çmimeve per pozicionet ne fjale, nga kërkesa prej I 0% duke e rritur ne 20%, e cila si e tille është pranuar nga ana e OE i rekomanduar me shpërblim te kontratës. 4. Po ashtu duke u nisur nga kërkesa e vendimit te OSHP-se lidhur me hulumtimin e tregut, përkundër faktit se tregu është hulumtuar para se te iniciohet ky aktivitet i prokurimit ashtu siç përcaktohet me nenin 4 dhe nenin 13 te RRPP Nr.001/2022, AK përsëri e ka ndërmarre një veprim te tille dhe nga dy kërkesa te OE te ndryshëm (Gartten GJ dhe TehnoBurimi - Njësia ne Gjilan) qe janë prodhues te elementeve te betonit e ka pranuar nje oferte me date 14.09.2023 ne kuptim te analizimit te çmimeve te tregut lidhur me artikujt e pozicioneve qe jane konsideruar nga ana e panelit si çmmime jo-normalisht te uleta. Per me teper oferten ne fjale e gjeni bashkëngjitur me përgjigjen e AK-se. Si perfundim, AK konsideron dhe eshte i bindur se e ka bere zgjidhjen e duhur te dhenies se kontrates OE me oferten me te lire te pergjegjshme duke u bazuar ne tiparet e parimimit te ekonomicitetit, respektivisht ruajtjes se parase publike, parimit te efikasitetit dhe efektivitetit dhe ne perputhje te plote me kerkesat procedurale dhe qenesore te dispozitave te nenit 59, nenit 60, nenit 61 te LPP-se (dhe Kerkesave qe dalin nga Vendimi PSH-OSHp 379/2023), duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit qe te siguroj menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve dhe burimeve publike ashtu siç parashihet me nenin 1 dhe 6 te ketij ligji."

- Poashtu janë bashkangjitur edhe dokumentet si në vijim:

1. Kërkesë për ofertë e AK-së e cila mbanë datë 11.09.2023 nga z.Kujtim Bajrami ZPP, për kompaninë "Tehnoburimi". Kërkesa është e nënshkruar nga ZPP dhe vulosur nga AK.
2. Kërkesë për ofertë e AK-së e cila mbanë datë 11.09.2023 nga z.Kujtim Bajrami ZPP, për kompaninë "Gartten GJ Sh.p.k". Kërkesa është e nënshkruar nga ZPP dhe vulosur nga AK.
3. Është dorëzuar edhe sqarimi i pranua nga OE EL-Bau i datës 13.09.2023 së bashku me emailat dhe shkresat rikonfirmuese të kompanive N.P.T. "BESHI COM" dhe "EKEN BETON".
4. Ofertë nga kompania "Tehnoburimi" e cila mbanë datën 14.09.2023 nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i kompanisë, në të cilën shënohet "Lidhur me kerkesen dhe interesimin e shprehur nga ana juaj, ne ju dorzojme oferten per elementet e betonit te

pershkruara ne vijim:

1	Furnizimi , transporti dhe punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve te mbyllura ne disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikëqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (ne çmim te llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor)		
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1200 mm	m'	1
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1000 mm	m'	1
	Gyp prej betoni të armuar Ø 800 mm	m'	1
	Gyp prej betoni të armuar Ø 600 mm	m'	1
	Gyp prej betoni të armuar Ø 500 mm	m'	1
	Gyp prej betoni të armuar Ø 400 mm	m'	1
2	Punimi i kokave hyrëse dhe dalëse nga betoni i armuar, varësisht prej diametrit te gypit.		
	Ø 1200 mm	copë	1
	Ø 1000 mm	copë	1
	Ø 800 mm	copë	1
	Ø 600 mm	copë	1
	Ø 500 mm	copë	1
	Ø 400 mm	copë	1

<u>Sqarimi i ekspertit për pretendimin ankimor 1</u>

- Eksperti sqaron se në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta të konstatuara sipas kritereve të nenit 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik (më tej RrPP), AK ka zbatuar procedurën inter partes konform nenit 41.2 RrPP dhe se sqarimet e pranuara bien nën kriterin vlerësues të definuar në nenin 41.8 përkatësisht pikës c) të RrPP ku thuhet: "*Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: […] c) çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve*".
- Më tej, sipas provave shkresore të prezantuara nga AK, në kuptim të zbatimit të vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së numër 379/2023, sipas shkresave në procedurë është evidente se AK ka ndërmarrë veprime në hulumtimin e tregut, dhe se çmimet e ofertës së pranuar për pjesën për punët e lëshesave janë 8 % më të larta se çmimi i ofertës së OE të rekomanduar.
- Andaj, konform nenit 41.10 të RrPP, ku përcaktohet se pas pranimit me shkrim të sqarimeve nga OE i rekomanduar AK vlerëson se nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë, AK në bazë të sqarimeve të pranuara është bindur se oferta e OE është e përgjegjshme edhe duke marrë për bazë faktin e hulumtimit të tregut dhe pranimit të masës për rritjen e sigurimit të ekzekutimit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor lidhur me ofertën e OE ankues</u>

- OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me rregullativen për prokurim publik, duke e cilësuar OE ankues si të pasuksesshëm dhe në të njëjtën kohë duke e cilësuar ofertën si të dëmshme financiarisht për AK-në.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- AK në vendimin e datës 22.09.2023 përkatësisht në letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, ndër të tjera ka vendosur arsyetimin: "*Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin me te ulet ne mesin e tenderëve qe plotësonin kërkesat e dhëna ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Për me tepër, si rezultat i rivlerësimit, AK i ka bere analize edhe ofertës te paraqitur nga ana e juaj dhe kemi vlerësuar se ne ofertën e juaj ka pozicione me çmime mbivlerësuese dhe ekstremisht te shtrenjta siç është tabela me pozicionet për punët përgatitore për fillimin e punimeve që për 1 km vetëm për punët përgatitore i kushtojnë buxhetit te AK-se 104,850.00€ me diferencë prej 93,350.00€ apo 912 % me shtrenjte ne krahasim me raport me çmimin prej 11,500.00 për këto pozicione nga oferta e OE i shpërblyer me kontrate. Me detalisht e gjeni te bashkëngjitur analizën ne forme tabelore. Prandaj, AK vlerëson se kjo oferte është e dëmshme financiarisht për buxhetin e AK-se edhe sipas parimeve themelore te prokurimit publik lidhur me qëllimin e ligjit te përcaktuar sipas nenit 1 dhe efikasitetit dhe efektivitetit sipas nenit 6 te LPP-se."*
- Në këtë aktivitet lloji i kontratës është kornizë pa përcaktimin e sasive indikativë dhe duke aplikuar metodën për peshimin e çmimeve, ku pjesa përgatitore përbën peshën prej 5% të vlerës së ofertës. Njësia e përcaktuar për pozicion është metë gjatësi. Rrjedhimisht secili nga dy pozicionet për secilën rrugë i bie që shumëzohet me numrin e metrave gjatësi.
- OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë, ku në pjesën e punëve përgatitore ka ofertuar duke vendosur çmimin e përgjithshëm për pjesë prej 88.00 euro, përkatësisht, për pozicionin "*1. Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues në vendpunishte."* ka ofertuar me çmim 49.01 euro për njësi (një metër) dhe pozicionin "2.*Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet më procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e defekteve."* ka ofertuar me çmim 39 euro (për një metër).

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

- Eksperti fillimisht sqaron në kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit ku nuk është definuar sasia indikative dhe është përdorur peshimi i çmimit sipas grupeve të pozicioneve, fakti që OE ankues ka ofertuar me çmim të caktuar ka ndikuar që i njëjti të jetë në pozicionin përkatës të renditur sipas çmimit të peshuar. Në rrethana të tilla kur nuk dihen sasitë indikativë dhe kur kërkohet të mirëmbahen rrugë pa i ditur dimensionet, si praktikë e mirë është që njësia e punëve përgaditore të përcaktohet si një njësi apo paushall, pasi që ndikon në ofertim dhe vlerësim më objektiv dhe shpenzim me racional të buxhetit. Megjithatë, të gjithë OE pjesëmarrës duke dorëzuar ofertë i kanë marrë si të mirëqena dokumentet e tenderit dhe kushtet e përcaktuara. Andaj, marrë për bazë faktin se njësia matëse e pozicioneve të mobilizimit dhe kontrollimit të instalimeve nëntokësore është përcaktuar me metër gjatësi, eksperti sqaron se sipas çmimit të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë për punët përgaditore (88 euro) në një shembull të thjeshtë nëse për tre vite sa është kohëzgjatja e kontratës, ekziston nevoja të mirëmbahet vetëm nga një rruge në secilin vit me një gjatësi rreth 600 metra, atëherë i bie që për vetëm 3 rrugë, vetëm për punë përgatitore do të shpenzohej 33 % të vlerës së mjeteve të parashikuara për

këtë kontratë. Ndërsa në rastin kur do të duhej të mirëmbaheshin nga 3 rrugë në vit në gjatësi rreth 600 metra, atëherë vetëm për punë përgatitore pa asnjë pozicion tjetër do të shpenzohej i tërë buxheti i parashikuar për këtë aktivitet.

- Si përfundim, përkundër që sipas raporteve të vlerësimit dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së OE ankues i plotëson kriteret e përzgjedhjes, ekzekutimi i kontratës me çmimet e ofertës së OE të ankues bien ndesh me përcaktimin e Nenit 6 të LPP-së ku kërkohet që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet pjesërisht si e pabazuar (për pretendimin ankimor 2) dhe eksperti rekomandon që konform sqarimeve të mësipërme, AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **FORTESA SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu